

OUCH!

NË KËTË BOTIM..

- Informatat tuaja
- Fshirja e pajisjes suaj
- SIM / Kartat e jashtme

Hedhja e pajisjes suaj mobile

Përmbledhje

Pajisjet mobile, sikurse janë smartphonët dhe tabletët vazhdojnë të avancohen dhe të zbulojnë risi me një ritëm marramendës. Si rezultat i kësaj shumica nga ne i zëvendësojmë ato gati çdo 18 muaj. Për fat të keq shumë njerëz thjesht i hedhin pajisjet e tyre mobile pa menduar se sa shumë të dhëna personale mund të jenë grumbulluar në ato pajisje. Në këtë broshurë ne do të mbulojmë disa sqarime se çfarë informata personale mund të jenë në pajisjen tuaj mobile, dhe si

mund t'i fshini ato në mënyre të sigurt para se të hidhen apo të kthehen. Nëse pajisja juaj mobile ju është dhënë juve nga punëdhënësi juaj ose ka të dhëna të organizatës të ruajtur në të, sigurohuni me mbikqyrësin tuaj për mënyrat e duhura të bekapit dhe proceduras e organizatës para se të ndiqni hapat e mëposhtëm.

Botuesi i ftuar

Christopher Crowley (@CCrowMontance; +ChrisCrowley) është konsulent, me vendbanim në Washington, DC. Ai është udhëheqës i ligjëruesve në Institutin SANS në lëndën Mobile Device Security and Ethical Hacking (SEC575) si dhe autor i Incident Response Team Management (MGT535).

Informatat tuaja personale

Pajisjet mobile ruajnë shumë më shumë të dhëna se sa ju mund të dini, madje ndoshta edhe më shumë se kompjuteri juaj. Informatat e zakonshme që mund të ruhen në një pajisje mobile mund të jenë:

- Ku jetoni, punoni dhe vendet që ju vizitoni më shpesh
- Informatat mbi kontaktet tuaja në adresarin tuaj, duke përfshirë familjen tuaj, shoqërinë dhe bashkëpunorët.
- Historikun e thirrjeve të pranuar, të kryera dhe të humbura
- Mesazhet tekstuale dhe zanore
- Sesionet e bisedave brenda aplikacioneve si lojërat dhe mediumet sociale.
- Historiku i vendndodhjes i bazuar në koordinatat GPS ose historiku i antenës celulare
- Historia e shfletimit të internetit, cookies, dhe faqet e ruajtura lokalisht
- Fotografitë personale, videot, regjistrimet zanore dhe emaillet.
- Fjalëkalimet e ruajtura dhe qasja në llogaritë personale, sikurse janë llogaritë në email apo llogarinë bankare online.
- Qasje në fotografi, fajle dhe informata të ruajtura në Cloud
- Informata mbi shëndetin tuaj, si shtypja e gjakut, dieta etj.

Hedhja e pajisjes suaj mobile

Fshirja e pajisjes suaj

Sikur e vëreni mund të ketë sasi të madhe të informatave të ndieshme në pajisjen tuaj mobile. Pa marrëparasysh se si e hidhni pajisjen tuaj mobile, duke ia dhuruar dikujt, duke e shitur, apo duke e hedhur në mbeturina, më parë sigurohuni që i keni fshirë të gjitha informatat e ndieshme. Gjithashtu ju duhet t'i fshini të dhënat tuaja edhe nëse jeni duke e kthyer pajisjen tuaj mobile apo duke e zëvendësuar atë me një të re. Nëse nuk e bëni këtë, kushdo që përfundon ta marrë pajisjen tuaj mobile mund të ketë qasje në të dhënat tua fare lehtë. Mirëpo para se të filloni fshirjen e të dhënave tuaja, me siguri ju do të donit të bëni një kopje të të dhënave tua, duke përfshirë fotografiitë, videot apo ndonjë informatë tjetër. Në momentin që i fshini të dhënat tuaja ju mund të mos jeni më në gjendje t'i ktheni ato të dhëna.

Pasi t'i keni bërë një kopje të dhënave tuaja atëherë ju duhet t'i fshini ato në mënyrë të sigurt. Thjesht duke i fshirë të dhënat, fotografitë nuk është e mjaftueshme.

Të dhënat që thjesht fshihen mund të kthehen pa

problem duke përdorur programe pa pagesë që mund të gjenden në Internet. Në vend të fshirjes, ju do të dëshironit t'i fshini në mënyrë të sigurt të dhënat tuaja në atë pajisje. Fshirja e sigurt mbishkruan çdo informatë në pajisje duke siguruar kështu që të dhënat nuk mund të rikthehen. Mënyra më e thjeshtë ta bëni këtë është të përdorni funksionin "kthimi në gjendje të fabrikës" (ang. "factory reset"). Kjo e kthen pajisjen në gjendjen si ka qenë në momentin kur e keni blerë. Ne jemi bindur që kjo është mënyra më e sigurt për të ofruar siguri dhe thjeshtësi në heqjen e të dhënave personale nga një pajisje mobile. Ky funksion dallon varësisht nga pajisja; të listuara më poshtë janë hapat që duhet ndjekur për tri pajisjet më të njohura.

- Pajisja Apple iOS: Settings | General | Reset | Erase All Content and Settings
- Pajisja Android: Settings | Privacy | Factory Data Reset
- Pajisja Windows Phone: Settings | About | Reset Your Phone

If you still have questions about how to do a factory reset, check your owner's manual or manufacturer's website. Remember, simply deleting your personal data is not enough as it can be easily recovered.

SIM & Kartat e jashtme

Përveç të dhënave të ruajtura në pajisjen tuaj, ju duhet të keni parasysh se çfarë duhet të bëni me kartën tuaj SIM (Subscriber Identity Module). Një kartë SIM është ajo që përdoret nga pajisja mobile për të bërë lidhje celulare apo data. Kur ju bëni një kthim në gjendje të fabrikës, karta SIM ruan informata mbi llogarinë tuaj. Nëse



Hedhja e pajisjes suaj mobile

do ta ruani numrin tuaj të telefonit, kontaktoni me shitësin e kartës për të transferuar SIM kartën tuaj. Nëse kjo nuk është e mundur, për shembull nëse pajisja juaj e re përdor kartë të ndryshme, ruajeni kartën e vjetër dhe shkatërroni fizikisht duke parandaluar kështu ripërdorimin e saj nga dikush tjetër.

Në fund, disa pajisje mobile përdorin kartë të veçantë SD (Secure Digital) për hapësirë shtesë të diskut. Këto karta zakonisht përmbajnë fotografi, aplikacione të ndryshme për smartphone, dhe të dhëna tjera të ndjeshme. Mos harroni t'i hiqni këto karta prej pajisjes suaj celulare para se ta hidhni apo largoni pajisjen tuaj mobile (në disa pajisje, kartat tuaja SD mund të jenë të fshehura prapa pjesës së baterisë). Këto lloj kartash mund të ripërdoren në pajisjen e re mobile, ose mund të përdoren në kompjuterin tuaj me anë të një adapteri USB. Nëse ripërdorimi është i pamundur atëherë si në rastin e kartës SIM, ne ju rekomandojmë ta shkatërroni atë.

Nëse nuk jeni të sigurtë për ndonjërin hap të sqaruar në këtë broshurë, çojeni pajisjen tuaj mobile te dyqani ku e keni blerë dhe kërkoni ndihmë nga një teknik i trajnuar. Në fund, nëse jeni duke e hedhur në plehra pajisjen tuaj mobile, ne ju lusim ta merrni parasysh dhurimin e saj. Ka plot organizata bamirëse që pranojnë pajisje të përdorura mobile.

Mëso më shumë

Regjistrohuni në buletin tonë mujor për vetëdijësimin mbi sigurinë OUCH!, qasuni në arkivat e OUCH!, dhe mësoni më shumë mbi zgjidhjet për ngritjen e vetëdijes mbi sigurinë të ofruara nga SANS duke na vizituar në faqen <http://www.securingthehuman.org>.

Edicioni në shqip

Edicioni në shqip i OUCH! është përkthyer nga gjuha angleze nga Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano. Iliri është magjistër i shkencave në administrimin e rrjetave dhe sistemeve kompjuterike, është ligjërues në universitet për lëndë të ndryshme nga fusha e TI, dhe është përgjegjës për sigurinë e teknologjise informative në bankë. Jorida është përkthyes profesionale e gjuhës angleze në OSBE.

Burimet

NIST SP800-88 Rev. 1: http://csrc.nist.gov/publications/drafts/800-88-rev1/sp800_88_r1_draft.pdf

OUCH! Backups: <http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#september2013>

OUCH! botohet nga SANS Securing The Human dhe shpërndahet nën licencën [Creative Commons BY-NC-ND 3.0](https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/). Lejohet ta shpërndani këtë buletin ose ta përdorni për programet tuaja vetëdijësuese, për sa kohë nuk e modifikoni përmbajtjen e buletinit. Për përkthimet apo më shumë informata, ju lutemi na kontaktoni në ouch@securingthehuman.org.

Bordi editorial: Bill Wyman, Walt Scrivens, Phil Hoffman, Bob Rudis

Përkthyer nga: Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano